REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

5591

Maliq më 22.09.2026

Projekt-Vendim – NR. 6
Për "Dhënien e Ndihmës Financiare për familjet në nevojë"

Në mbështetje të ligjit nr .139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",ligji nr 9936,datë 26.06.2008,"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjit 121/2016 , "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Shqipëri" dhe në bazë të verifikimeve të bëra nga punonjësit e Ndihmës Ekonomike Maliq, të Njësive të Bashkisë Maliq për gjendjen social-ekonomike të familjeve i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

I. Miratim fondi për familjet e mëposhtëme:

Nr.	Emri Mbiemri	ID	Nj.Administrative	Shuma /Lekë
1	Albina Hysenllari	H65116161B	Maliq	20.000
2	Rajmonda Pillati	G95625029B	Libonik	20.000
3	Petrit Zeneli	G80505034P	Pojan	20.000

II. Fondet do të përballohen nga Buxheti i vitit 2026, si më poshtë :

Gr.	Kod. Prog.	Llog.eko	Emert.Llogarise	Vlera në lekë
00	10430	606	Fondi Social	60.000

III. Bashkëngjitur projekt-vendimit relacionin me gjëndjen Social–Ekonomike të familjes.

Konceptoi Pergj.Sek I Politikave Sociale
Miratoi:Dr. Drejtoria e Shërbimeve Sociale

(Emër Mbiemër)
J.Hoxha
E.Petrit

Nënshkrimi

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë
Tel. & Fax. 0861 2 2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Maliq më .09.2026

Relacion
Për "Dhënien e Ndihmës Financiare për familjet në nevojë"

Në mbështetje të ligjit nr .139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",ligji nr 9936,datë 26.06.2008,"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjit 121/2016 , "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Shqipëri" dhe në bazë të verifikimeve të bëra nga punonjësit e Ndihmës Ekonomike Maliq, të Njësive të Bashkisë Maliq për gjendjen social-ekonomike të familjeve të mëposhtme rezultoi se:

1.Albina Hysenllari.

Znj.Albina Hysenllari është banore e Fshatit Maliq, Bashkia Maliq.Familja e Albinës përbëhet nga 2 anëtarë nga znj.Albina, bashkëshorti i saj z.Heqerem.Znj.Albina trajtohet me pagesën e aftësisë së kufizuar (PAK) grupi i parë. Familja jeton në kushte të vështira ekonomike pasi zonja Albina vuan nga trompoza në këmbë dhe nga disa sëmundje të tjera shoqëruese. Problemet shëndetësore ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e saj të përditshme dhe në mundësinë për të qenë aktive në tregun e punës apo për të siguruar të ardhura shtesë për familjen.Bashkëshorti i zonjës është i papunë dhe situata ekonomike rëndohet për shkak të gjendjes shëndetësore, znj. Albina dhe ka nevojë për kujdes të vazhdueshëm, kontrolle mjekësore dhe trajtime sipas rekomandimeve të mjekëve. Këto nevoja shoqërohen me shpenzime të vazhdueshme për barna, vizita, analiza dhe nevoja të tjera shëndetësore, duke rënduar më tej buxhetin e familjes. Në këto kushte, i drejtohemi Këshillit Bashkiak Maliq për miratimin e një ndihme financiare, me qëllim përballimin e shpenzimeve të domosdoshme.

2.Rajmonda Pillati.

Znj. Raimonda Pillati është banore e fshatit Libonik, Njësia Administrative Libonik, Bashkia Maliq. Familja Pillati përbëhet nga katër anëtarë znj. Raimonda Pillati, bashkëshorti i saj, z. Jorgo Pillati, dhe dy fëmijët e tyre.Familja jeton në kushte të vështira ekonomike dhe përballet me vështirësi në përballimin e shpenzimeve të përditshme familjare. Të ardhurat e familjes janë të pamjaftueshme për të mbuluar nevojat bazë dhe shpenzimet e tjera të domosdoshme që lidhen me mirëmbajtjen e familjes dhe kujdesin ndaj fëmijëve.Gjendja ekonomike dhe sociale e

familjes është rënduar ndjeshëm kohët e fundit për shkak të problemeve shëndetësore të znj. Raimonda Pillati, e cila është diagnostikuar me sëmundje onkologjike. Për shkak të gjendjes së saj shëndetësore, ajo ka nevojë për kontrolle dhe vizita të shpeshta mjekësore, ekzaminime, trajtime dhe ndjekje të vazhdueshme shëndetësore, të cilat shoqërohen me shpenzime shtesë për familjen.Në këto kushte, familja Pillati ndodhet përballë një situate të vështirë ekonomike, pasi duhet të përballojë edhe kostot që lidhen me trajtimin dhe kujdesin shëndetësor të znj. Raimonda. Në këto kushte, i drejtohemi Këshillit Bashkiak Maliq për miratimin e një ndihme financiare, me qëllim përballimin e shpenzimeve të domosdoshme.

3.Petrit Zeneli.

Z. Petrit Zeneli është banor i fshatit Pojan, Njësia Administrative Pojan, Bashkia Maliq. Familja Zeneli përbëhet nga tetë anëtarë: z. Petrit Zeneli, bashkëshortja e tij, znj. Shefike Zeneli, dhe gjashtë fëmijët e tyre.Familja Zeneli ndodhet në kushte shumë të vështira ekonomike dhe përballet me vështirësi të mëdha në përballimin e nevojave dhe shpenzimeve të përditshme familjare. Situata ekonomike është rënduar veçanërisht për shkak të gjendjes shëndetësore të kryefamiljarit, z. Petrit Zeneli, i cili, për shkak të sëmundjes nga e cila vuan, nuk ka mundësi të ushtrojë një aktivitet pune dhe të sigurojë të ardhura të mjaftueshme për familjen.Nga ana tjetër, bashkëshortja e tij, znj. Shefike Zeneli, nuk ka mundësi të punësohet, pasi duhet të qëndrojë në familje për t'u kujdesur për gjashtë fëmijët dhe për të përmbushur nevojat e tyre të përditshme. Për shkak të numrit të madh të anëtarëve të familjes, shpenzimet për ushqim, veshmbathje, arsim, kujdes shëndetësor dhe nevoja të tjera bazë janë të konsiderueshme dhe të vështira për t'u përballuar. Në këto kushte, i drejtohemi Këshillit Bashkiak Maliq për miratimin e një ndihme financiare, me qëllim përballimin e shpenzimeve të domosdoshme.

Konceptoi Pergj.Sek I Politikave Sociale
Miratoi:Dr. Drejtoria e Shërbimeve Sociale

(Emër Mbiemër)
J.Hoxha
E.Petriti

Nënshkrimi

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë

Tel. & Fax. 0861 2 2026